



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRA

01 Nr. / Br. 51/23

Nr. A. fq. / Br. s. -1-

Data / Datum: 24.02.2023

VUSHTRRI - VUÇITRA



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika "d" lidhur me nenin 17, shkronja "a" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 2, paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr.05/L-100 për Ndhimën Shtetërore, si dhe nenin 19, pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2023 (gjegjësisht vazhdimi i mbledhjes më 24 shkurt), merr këtë:

### VENDIM

#### PËR LIRIMIN NGA PAGESA E TAKSËS PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE, SI DHE KIOSKAVE NGA DRURI PËR MË PAK SE NJË VIT

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë për më pak se një vit, si dhe kioskat nga druri që jepen në shfrytëzim më pak se një vit nga data 3.1.2023 deri më 22.12.2023.
2. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive, të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike, vlera e përgjithshme e këtyre masave përlllogarit të jetë 10000.00€, për kioskat nga druri, ndërsa për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë, shuma përlllogarit të jetë 4300.00€, për periudhën e cekur si në pikën e parë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria për Inspektive.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRA

D. Nr. / Br. \_\_\_\_\_ 52/23  
Nr. i fq. / Br. sh \_\_\_\_\_ - 1 -  
Data: / Datum \_\_\_\_\_ 24.02.2023  
VUSHTRRI - VUČITRA



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **23 shkurt 2023 (gjegjesisht vazhdimi i mbledhjes më 24 shkurt)**, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIM TË VENDIMIT LIDHUR ME THEMELIMIN E KËSHILLIT**  
**KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01-Nr. 24/22 i datës 31.1.2022 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si në vijim:

- 1.1 Në pikën 1.14 Sedat Durmishi, përfaqësues i komunitetit ashkali, shkarkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së;
- 1.2 Në pikën 1.15 Brendon Shaqiri, përfaqësues i komunitetit rom, shkarkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së;
- 1.3 Në paragrafin 1, pika 1.3 Miradije Maloku, ish - Drejtore e Drejtorisë për Arsim, pushon të jetë anëtare e KKSB-së;
- 1.4 Në pikën 1.10 Simo Çimburoviç, përfaqësues i kishës ortodokse serbe, pushon të jetë anëtar i KKSB-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

  
**Melihate Basholli-Latifi**  
\_\_\_\_\_  
**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br. 53/23

Nr. i fq. / Nr. sh. - 1 -

Data / Datum 24.02.2023

VUÇITRAN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 5, pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, nenin 12, paragrafi 12.2, pika “d” Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, dhe nenin 19, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **23 shkurt 2023 (gjegjësisht vazhdimi i mbledhjes më 24 shkurt)**, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR EMËRIM TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE**  
**DHE ZËVENDËSDREJTORËVE NË KOMUNËN E VUSHTRRIË**

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për përzgjedhje për vendet e punës, drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:

- 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe i personelit në DKA;
- 1.2. Burim Gjaka, drejtor i SHFMU "Mustafë Shyti" Oshlan;
- 1.3. \_\_\_\_\_, përfaqësues i MASHT-it.

2. Komisioni do t'i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar.

3. Komisioni i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi ka mandat për një vit shkollor.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe komisioni i lartcekur.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**  
  
\_\_\_\_\_  
**Kryesuese e Kuvendit**

